



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 shtator 2015
Nr. ref.:835/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI15/15

Parashtrues

Hysni Hoxha,
kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit

**Kërkesë për interpretimin ligjor të nenit 100 të Ligjit për Prokurimin
Publik në Republikën e Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Hysni Hoxha, kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (në tekstin e mëtejshëm: OSHP). Parashtruesi nuk kishte sqaruar nëse kërkesën e parashtron si individ, apo në emër të OSHP-së. Megjithatë, ai në kërkesë ka potencuar funksionin e tij zyrtar dhe kërkesën e ka vulosur me vulën zyrtare të OSHP-së.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë vendim të autoriteteve publike.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretimin e nenit 100 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), me të cilin parashihen kushtet dhe kualifikimet profesionale që duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u zgjedhur anëtarë të OSHP-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI15/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.
8. Më 1 prill 2015, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e formularit të kërkesës të Gjykatës në mënyrën e paraparë me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës.
9. Më 16 prill 2015, Gjykata pranoi nga parashtruesi formularin e plotësuar të kërkesës.
10. Më 7 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 mars 2014, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar parashtruesin e kërkesës dhe 4 (katër) anëtarë të tjerë të OSHP-së me mandat 5 (pesë) vjeçar. Kuvendi gjithashtu caktoi parashtruesin e kërkesës Kryetar të OSHP-së.

12. Emërimi i Kryetarit dhe i anëtarëve të OSHP-së ishte bërë në përputhje me procedurat e parapara me nenin 100.4 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
13. Me nenin 100.5, nënpara. 5.4 të po këtij Ligji, përcaktohet se një prej kushteve vendimtare për emërimin e kandidatëve për anëtarë të OSHP-së është si në vijim:

“5.4. të plotësojë kriteret për tu emëruar si gjykatës;”

14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që t'i interpretojë kushtet të cilat parashihen në këtë Ligj dhe të vendosë nëse imuniteti i anëtarëve të emëruar në OSHP është i nivelit të njëjtë me atë që iu garantohet gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi nuk saktëson ndonjë nen të Kushtetutës që mund të jetë shkelur apo që mund të interpretohet, por kërkon që Gjykata Kushtetuese të interpretojë çështjen ligjore të ngritur nga ai dhe të parashtruar në paragrafin 14.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, me të cilin është përcaktuar:

“Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

e) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën;

20. Lidhur me kërkesën, Gjykata thekson se me nenin 4.6 të Kushtetutës së Kosovës është përcaktuar se *"Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës"*, ndërsa me nenin 112.1 po ashtu të Kushtetutës është përcaktuar se *"Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën"*.
21. Nga sa u tha më lart, është tërësisht e qartë se Gjykata Kushtetuese bën interpretimin e Kushtetutës dhe vlerëson përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, por me asnjë dispozitë kushtetuese dhe në asnjë rrethanë ajo nuk është e autorizuar të bëjë interpretimin e dispozitave konkrete të ligjit si një akt juridik unik.
22. Gjykata, për më tepër, vë në dukje se në asnjërën nga pikat e nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, nuk është paraparë për asnjërën nga palët e autorizuar e drejta që palët të ngrenë çështje sikur janë ngritur në këtë rast, thjesht sepse ato çështje janë jashtë juridiksionit të Gjykatës.
23. Është evidente që për të vendosur lidhur me një kërkesë të parashtruar para saj, Gjykata duhet të ketë juridiksion material dhe e ka për detyrë të kujdeset lidhur me këtë juridiksion gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës. Në të njëjtën mënyrë, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në rastin *X kundër Gjermanisë*, arsyetoi:
- "Sipas nenit 25, § 1 të Konventës, vetëm shkelja e pretenduar e një prej të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë mund të jetë objekt i një kërkesë të paraqitur nga një person, organizatë joqeveritare ose grup individësh."* (Shih, *X kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 7462/76).
24. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka juridiksion material për vendimmarrje për çështjen e kërkuar dhe kërkesa është *ratione materie* e papajtueshme me Kushtetutën (Shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës në Rastin KI115/12, të parashtruesit *Fadil Salihu*, të 25 janarit 2013), dhe si e tillë kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 7 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi